

INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAMI I LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE PËR KLASËN E 9-të

SHKURT, 2010

Koordinatori
Antoneta Remeq


HYRJE

Programi i gjuhës shqipe, klasa e 9^{te} përmbyll ciklin e zhvillimit të kësaj lënde në arsimin e mesëm të ulët. Ai është vazhdim i programeve të viteve të mëparshme dhe mbështetet tek parimi:

- linear
- koncentrik
- integrues,

duke rritur gradualisht nivelin shkencor të njohurive dhe duke zhvilluar aftësitë e shprehitë.

Këto parime bëjnë që programi i gjuhës shqipe të krijojë hapësira dhe mundësi konkrete për risi të mirëfillta në zbërthimin e tij në praktikën e përditshme mësimore. Njohuritë gjuhësore dhe kthimi i tyre në shprehje do të arrihet përmes kërkimit, përzgjedhjes dhe zbatimit të metodave e teknikave bashkëkohore për të realizuar dhënien, përvetësimin dhe praktikimin e:

- aftësive komunikuese me gojë dhe me shkrim,
- njohurive për sistemin gjuhësor të shqipes,
- qëndrimeve vlerësuese e vetëvlerësuese,

me qëllim që nxënësit përmes gjuhës shqipe, të shprehin nocione, koncepte dhe të transmetojnë mesazhe.

Nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe zhvillohen shprehje komunikuese, të cilat realizojnë në tërësi aktin e komunikimit: *të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit* dhe nguliten e sistemohen njohuri të caktuara për gjuhën shqipe, sistemin e saj gjuhësor dhe normën e saj standarde, duke i bërë nxënësit më të vetëdijshëm për të.

Lënda e gjuhës shqipe nuk ka qëllim në vetvete riprodhimin mekanik të njohurive gjuhësore dhe letrare, por përdorimin e tyre në funksion të zhvillimit të aftësive dhe shprehive komunikuese.

Integrimi i gjuhës shqipe me leximin letrar është i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm, pasi organizon tërë strukturën dhe përmbajtjen e lëndës së gjuhës shqipe. Ky integrim gjallon për vet natyrën e ekzistencës së letërsisë si art i fjalës në saje të gjuhës. Procesi integrues do të ngrejë cilësisht orientimin dhe nxitjen e të mësuarit të integruar, duke i ndihmuar nxënësit të gjejnë shpejt dhe me lehtësi informacionin që u duhet, si edhe ta përpunojnë atë: a) duke zbatuar aftësitë e fituara, b) duke i nxitur të mbajnë qëndrim, c) duke i pozicionuar e lënë të lirë të marrin vendime për probleme të ndryshme, në situata të caktuara të njohura ose të panjohura

Aftësimi i nxënësit për jetën do të arrihet përmes:

- të dëgjuarit & të folurit,
- të lexuarit,
- të shkruarit,
- njohuri rreth sistemit të gjuhës.

E rëndësishme në përvetësimin e të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit, të folurit, është që të kuptohet se:

- a) përdorimi i gjuhës është një proces aktiv për ndërtimin e domethënies a kuptimit;
- b) nxënësit e realizojnë të nxënit jo duke i shtuar aftësitë në mënyrë mekanike, por duke i zhvilluar ato hap pas hapi;
- c) gjuha zhvillohet në një kontekst social dhe kulturor, ndaj procesi i përvetësimit të saj është i lidhur edhe me të tjerët.

2

I. SYNIMET E LËNDËS

Programi i gjuhës shqipe për klasën e 9^{te} zgjeron dhe thellon njohuritë e marra, si dhe forcon bazat mbi të cilat ndërtohet mësimi i kësaj lënde jo vetëm gjatë periudhës shkollore, por edhe më tej.

Lënda synon të zhvillojë tek nxënësit::

- komunikimin me shkrim dhe me gojë për nevoja vetjake në mënyrë të saktë dhe me kulturë gjuhësore;
- formimin dhe zhvillimin vetjak intelektual, emocional, shoqëror, estetik dhe moral;
- përvetësimin e gjuhën shqipe në atë nivel e cilësi që të mundësojë të mësuarit e vazhdueshëm.

II. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të klasës së 9^{te} në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit duhet:

- të komunikojnë për qëllime të ndryshme, duke i dhënë kuptim të menduarit të tyre nëpërmjet të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit;
- të përvetësojnë gjuhën shqipe në atë nivel e cilësi, që të mundësojë të mësuarit e tyre në vazhdimësi për tërë jetën;
- të shkruajnë me imagjinatë dhe ndjenjë rreth dukurive të jetës dhe të botës që i rrethon, në marrëdhënie të tilla, si: dialogu, mirëkuptimi, loja e bashkëpunimi;
- të kenë konceptet, njohuritë dhe aftësitë e domosdoshme për moshën të cilat i ndihmojnë në përpunimin e shijeve estetike të tyre;
- të mundësojnë një formim vetëvlerësues të nxënësve për aftësitë vetjake të arritura për t'i shndërruar ato në faktorë të të nxënësve të metejshëm;
- të zhvillojnë imagjinatën dhe ndjenjat rreth dukurive të jetës dhe botës që i rrethon;
- të zbatojnë njohuri dhe teknika të procesit të të lexuarit për t'u bërë lexues të pavarur, si dhe për të kuptuar tekste të ndryshme, letrare dhe joletrare
- të zhvillojnë mendimin e pavarur, kritik e krijues;
- të pasurojnë dhe ngulisin shprehitë folëse, shkruese, lexuese në përshtatje me objektin e ligjërimit;
- të flasin në mënyrë efektive dhe ndikuese për audiencë, qëllime, situata dhe kontekste të ndryshme;
- të zhvillojnë ndjenjën e identitetit kombëtar dhe kulturor;
- të shkruajnë tekste të llojeve të ndryshme duke respektuar kriteret e duhura sipas llojit të shkrimit.

III. LINJAT DHE NËNLINJAT E PËRMBAJTJES

- Të dëgjuarit & Të folurit

1. Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime
2. Të dëgjuarit dhe të folurit në grup dhe në publik rreth teksteve të ndryshme
3. Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare
4. Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde

- Të lexuarit

1. Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion
2. Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate
3. Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare
4. Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje
5. Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe

- Të shkruarit

1. Të shkruarit funksional dhe për nevoja vetjake
2. Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë
3. Njohuri rreth gjuhës

- Njohuri rreth sistemit të gjuhës

1. Sintaksë
2. Morfologji
3. Leksikologji
4. Kulturë gjuhe

**IV. KONCEPTET KRYESORE SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE.
OBJEKTIVAT SPECIFIKË**

(35 javë mësimi me 5 orë në javë = 175 orë gjithsej)

LINJA: Të dëgjuarit dhe të folurit (15 orë)

Nënlinjat	Objektivat	Përmbajtja
<p>1. Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime</p>	<p>Në përfundim të klasës së 9^{te} nxënës/i,-ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ndjekë me vëmendje dhe në mënyrë të përgjegjshme folësin ose informacionin që vjen nga burime të ndryshme; - të flasë me diksion të qartë dhe me intonacionin përkatës; - të zbatojë këshilla, udhëzime dhe orientime të ndryshme; - të japë këshilla, udhëzime dhe orientime të ndryshme; - të interpretojë informacionin e marrë nga burime të ndryshme duke sjellë fakte dhe vlerësime të reja; - të mbajë shënime që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm ; - të përdorë përpunimin e njëkohshëm të të dhënave; - të plotësojë këshillat e të tjerëve; - të përdorë informacionin e marrë duke e riinterpretuar atë, sipas aftësive vetjake të fituara; - të bëjë vlerësime për mesazhe dhe situata të ndryshme. 	<p>Tekste që paraqesin situata dhe probleme të jetës së përditshme.</p> <p>Tekste të fushave të ndryshme</p> <p>Materiale informative të marra nga burime të ndryshme si: TV, radio, gazeta, revista, internet.</p> <p>Tabela, harta orientuese qyteti apo gjeografie, fletëpalosje, guida të ndryshme për të gjetur ose për të drejtuar të tjerët.</p> <p>Tema të mundshme orientimi në aeroport, mjedise publike e sportive, ekspozita, biblioteka, koncerte, lojëra të ndryshme, udhëzime përdorimi etj.</p>
<p>2. Të dëgjuarit dhe të folurit në grup dhe në publik rreth teksteve të ndryshme</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të respektojë kërkesat e diskutimit në grup; - të përdorë gjuhë të përshtatshme për çdo situatë të krijuar; - të vlerësojë përmbajtjen e një informacioni të dëgjuar; - të marrë rolin e drejtuesit dhe të dëgjuesit në një diskutim; - të mbajë një qëndrim të caktuar (e mbështet ose e kundërshton) rreth informacioneve të 	<p>Materiale me temë nga veprimtaria e përditshme brenda ose jashtë shkolle.</p> <p>Tekste letrare e joletrare që pasurojnë horizontin e nxënësit.</p> <p>Materiale që nxisin të marrë role të ndryshme, krijojnë situata debati, problemore, që kërkojnë vëmendje</p>

	<p>dëgjuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të plotësojë me detaje shtesë informacionin e dëgjuar; - të tregojë përvojën e tij në mënyrë të strukturuar, duke respektuar faktorin kohë; - të përdorë përmbajtje të përshtatshme për qëllime, audiencë dhe kontekste të ndryshme; - të përdorë pyetjet: <i>kush?, kur?, ku?, pse?, çfarë?</i> kur diskutohen tema të ndryshme; - të përgjigjet në mënyrë të përshatshme; - të përmbledhë informacionin e dëgjuar; - të përzgjedhë, ide, mendime, informacione për çështje që diskutohen; - të përdorë elemente verbale dhe joverbale në komunikimin gojor. 	<p>për analizë.</p> <p>Materiale me informacione të ndryshme që mundësojnë mendimet vetjake mbi informacionin e marrë.</p>
<p>3. Të dëgjuarit dhe të folurit për lloje dhe gjini të ndryshme letrare</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojë elemente formale dhe gjuhësore në tekste të ndryshme; - të përdorë saktë fjalorin kyç të teksteve të lexuara; - të përcaktojë elemente formale dhe gjuhësore në tekste të ndryshme letrare, por me të njëjtën temë; - të analizojë strukturat dhe tipat e ndryshëm të teksteve me qëllim të folurit e saktë; - të përdorë fjalët me ngjyrim emocional për t'i bërë ato pjesë të fjalorit vetjak; - të përdorë gjuhën e dramës në lojën me role; - të zbulojë të përbashkëtat dhe dallimet e elementeve gjuhësore të teksteve të ndryshme nëpërmjet krahasimit të tyre. 	<p>Tekste të ndryshme letrare për të analizuar struktura dhe tregues formalë sipas llojit të tekstit.</p> <p>Tekste me poezi, prozë poetike, monolog, dramë, reportazh, ese për të bërë vlerësimin krahasues për gjuhën dhe llojin.</p> <p>Tekste dramatike të llojeve të ndryshme (dramë, tragjedi, komedi, monodramë) për të bërë krahasime dhe vlerësuar gjuhën.</p> <p>Materiale të struktururara nga paraqitja, situata dramatike, komike, etj që plotësohen dhe përpunohen nga nxënësit.</p>
<p>4. Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde shqipe</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë drejt gjuhën standarde shqipe; - të diskutojë për fjalë e forma gramatikore që pasurojnë gjuhën shqipe; - të dallojë përdorimin e saktë dhe të gabuar në tekste letrare dhe jo letrare; - të shmangë përdorimet pavend të fjalëve dhe formave gjuhësore që dëmtojnë gjuhën shqipe; 	<p>Materiale letrare artistike dhe joartistike me përdorime pavend të fjalëve të huaja dhe strukturës sintaksore shqipe.</p> <p>Krahasime dhe vlerësime përmes materialit që është shkruar jo saktë dhe atij të shkruar sipas gjuhës standarde.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - të ushtrorë përdorimin e gjuhës standarde; - të shfrytëzojë përdorime të gjuhës korrekte të teksteve letrare ose joletrare për qëllime vetjake. 	Tekste letrare dhe joletrare me tematikë të caktuar, në gjini të ndryshme me ndërtime leksiko-gramatikor.
--	--	---

LINJA: Të lexuarit (65 orë)

Nënlinjat	Objektivat	Përmbajtja
1. Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion.	<p>Në përfundim të klasës së 9^{te} nxënës/i,-ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të lexojë me kuptim, qartë dhe me shqiptim të saktë, me qëllim të kuptuarit dhe marrjen e informacionit të duhur nga tekste të ndryshme; - të parafranojë tekste të ndryshme pa ndryshuar përmbajtjen; - të identifikojë informacionin e rëndësishëm në tekste të ndryshme; - të analizojë marrëdhëniet midis pjesëve të ndryshme të tekstit; - të përdorë shembuj, detaje specifike, përshkrime për të reflektuar mbi tekste të ndryshme; - të krahasojë informacione të marra nga burime të ndryshme, me qëllim përzgjedhjeje sipas interesave; - të zbulojë mesazhet që dalin nga tekstet e ndryshme por me tematikë të njëjtë; - të dallojë faktin nga opinioni; - të realizojë leximin shprehës në përshtatje me llojin e tekstit; - të vlerësojë tekstet e tipit joformal si burim informacioni alternativ; - të mbajë qëndrim duke argumentuar çështje të ndryshme; - të praktikojë rileximin për të ngulitur në kujtesë informacionin më të rëndësishëm. 	<p>Materiale të fushave të ndryshme që nxënësi realizon në programet shkollore.</p> <p>Materiale nga enciklopedi, revista shkencore dhe interneti me të drejtë përzgjedhje të informacionit që i duhet.</p> <p>Materiale të ndryshme informative që japin dhe forma të ndryshme komunikimi.</p>
2. Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të lexojë në mënyrë artistike dhe me ndjenjë tekste letrare; - të zbulojë domethënien e teksteve letrare; 	<p>Poezi, prozë, dramë.</p> <p>Tekste nga gjini të gjata letrare: novela, romani, me personazhe kryesore të pëlqyera nga</p>



<p>dhe zgjim imagjinate</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të zbërthejë me imagjinatë domethënien e teksteve; - të analizojë personazhe të teksteve të ndryshme, duke treguar vlerat pozitive të tyre; - të demonstrojë intuitë dhe imagjinatë gjatë procesit të të kuptuarit të teksteve letrare; - të përzgjedhë tekste që përmbushin interesat e veta; - të interpretojë në grupe të vogla dhe të mëdha. 	<p>nxënësit.</p> <p>Tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme të kurrikulave të ndryshme.</p> <p>Tekste origjinale dhe të përshtatura që nxisin krahasimin dhe mendimin kritik.</p> <p>Tekste letrare për të dalluar elementet e formës.</p>
<p>3. Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të lexojë tekste të llojeve të ndryshme letrare: poezi prozë, dramë; - të grupojë pjesët që lexon sipas gjinive dhe llojeve letrare; - të shpjegojë ndryshimet mes llojeve dhe gjinive letrare, duke u mbështetur në veçoritë kompozicionale dhe gjuhësore; - të zbërthejë figurat letrare duke treguar funksionin shprehës të tyre; - të përmbledhë idetë e teksteve të ndryshme për të mbajtur qëndrim kritik ndaj tyre; - të tregojë stilin e shkrimtarit; - të vlerësojë mjete gjuhësore në rrafshin leksikor, kohor, qëllimor; - të interpretojë funksionin artistik të figurave letrare: <i>apostrofi, paralelizmi figurativ, metafora, krahasimi, epiteti</i>; - të bëjë analiza të thjeshta mbi vargëzimin gjatë analizave artistike të teksteve poetike; - të dallojë personazhet- karaktere; - të përcaktojë pjesët kyç të tekstit për të krijuar pika orientimi. 	<p>Tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme.</p> <p>Tekste të tipit informativ për të bërë krahasime me tekste të tipit letrar.</p> <p>Vepra të letërsisë shqiptare dhe botërore të kohërave të ndryshme të përshtashme për këtë moshë.</p> <p>Paraqitja e figurave bazë letrare: <i>apostrofi, paralelizmi figurativ, metafora, krahasimi, epiteti</i> gjatë analizave artistike të materialeve letrare.</p> <p>Tekste letrare për të dalluar elementet e formës.</p>
<p>4. Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të lexojë me zë të lartë dhe me intonacionin e duhur për të nxjerrë domethënien e pjesës; - të interpretojë pjesë letrare të llojeve të ndryshme, duke respektuar karakterin poetik apo atë të prozës rrëfimore; 	<p>Tekste të llojeve të ndryshme ku nxënësi lexon në mënyrë interpretative.</p> <p>Tekste dramatike që janë të mundshme për t'u dramaturgizuar dhe për t'u luajtur me role nga</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë pjesë që përbëjnë "kulm" në poezi dhe në prozë, duke pasur parasysh: përmbajtjen dhe thelbin e pjesës, zbatimin e diksionit, theksave, pauzave me intonacionin e duhur; - të përdorë elemente të teknikës së recitimit gjatë leximit me zë; - të dramatizojë tekste të ndryshme epiko-lirike nga materialet në poezi apo prozë. 	nxënësit.
5. Të lexuarit për të praktikuar njohuritë rreth gjuhës standarde shqipe	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të lexojë duke respektuar njësitë funksionale brenda fjalisë; - të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të fushave të ndryshme, duke përdorur fjalorë të ndryshëm, internet, enciklopedi për fëmijë; - të përdorë fjalorë për shpjegimin e fjalëve të vështira dhe të panjohura; - të shfrytëzojë përdorime të gjuhës së figurshme nga tekste të ndryshme letrare; - të krijojë skedarin e librave që lexon; - të vlerësojë mënyrën sesi është përdorur gjuha standarde në ndërtimin e një teksti. 	<p>Tekste të fushave të ndryshme ku nxënësi mëson të përdorë fjalë specifike për një fushë të caktuar.</p> <p>Materiale të fushave të ndryshme shkencave shoqërore, natyrore etj.</p> <p>Terma që do t'i shtohen analizave në lidhje me tekstet: karakteret, vendosja e marrëdhënieve, motivet, idetë, plani i pjesës, konflikti, subjekti, kompozicioni.</p> <p>Terma të tjera të reja, si: faktet, debati, opinionin, mendimet, dekor, skenografi, vlerësimi grafikë, formë.</p>

LINJA: Të shkruarit (22 orë)

Nënlinjat	Objektivat	Përmbajtja
1. Të shkruarit funksional dhe për nevoja vetjake	<p>Në përfundim të klasës së 9^{te} nxënës/i,-ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshihet në të gjitha hapat e procesit të shkruarit: parashkrimi, skicimi, redaktimi, shkrimi, dorëzimi; - të shkruajë për qëllime të ndryshme; - të shkruajë për lexues të ndryshëm: mësues, prindër, shokë; - të realizojë shkrime të ndryshme sipas modeleve që i kërkohen: <i>CV, kërkesë zyrtare, përmbledhje, ese argumentuese dhe përshkruese</i> duke respektuar kriteret (ideja, organizimi strukturor, informacioni i 	<p>Forma të tilla të shkruari si: CV, kërkesë zyrtare, përmbledhje, ese argumentuese dhe përshkruese.</p>

	<p>rëndësishëm, rrjedha logjike, përzgjedhja e detajeve mbështetëse, përfundimet koherente) sipas llojit të shkrimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shkruajë pikat kyçe të një teme të dhënë; - të paraqesë me shkrim ide interesante; - të shkruajë për të dhënë informacion për të tjerët nëpërmjet përshkrimit dhe argumentimit; - të përdorë stil vetjak nëpërmjet përdorimit të shenjave dhe të strukturave të caktuara; - të përshkruajë përvoja vetjake, si dhe veprimtari të kryera në grup. 	
<p>2. Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë dukuri të natyrës sipas këndvështrimit të tij/saj imagjinar; - të shkruajë mbyllje interesante për ngjarje fantastiko-shkencor; - të përshkruajë heronjtë e tij imagjinarë duke përdorur fjalor të përshtatshëm; - të shkruajë poezi të shkurtra sipas një modeli të dhënë; - të shkruajë me imagjinatë për një temë të caktuar apo të zgjedhur nga ai/ajo; - të shkruajë mbyllje interesante, të ndryshme nga varianti i dhënë; - të përdorë fjalë dhe forma gjuhësore të cilat krijojnë imazhe të “gjalla” në mendjen e lexuesit; - të shkruajë në mënyrë estetike. 	<p>Përvoja vetjake të veçanta</p> <p>Shkrime fantastiko-shkencore, përralla, fabula.</p> <p>Shkrime për situata reale dhe joreale.</p>
<p>3. Njohuri rreth përdorimit të gjuhës</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të respektojë kërkesat gjuhësore sipas llojit të modelit të të shkruarit; - të përdorë shenjat e pikësimit sipas intonacionit të thënies: <i>presjen, dy pikat, kllapat, pikë presjen;</i> - të përdorë njohuri të gjuhës standarde për të redaktuar shkrimin vetjak dhe të të tjerëve; - të përdorë rregullat e pikësimit të shqipes standarde në të gjitha shkrimet e tij/saj. 	<p>Terminologji në përdorim, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Titulli, - Teksti, - Struktura e fjalisë (fjalja e thjeshtë tip, fjalja e përbërë. - Shenjat e pikësimit, - Hyrja, zhvillimi, mbyllja - Paragrafi - Fakti - Opinioni - Përfundimi



LINJA: Njohuri rreth gjuhës dhe sistemit të saj gramatikor (50 orë)

Nënlinjat	Objektivat	Përmbajtja
<p>Sintaksë 18 orë</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojë llojin e fjalive sipas gjymtyrës kryesore (njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe); - të dallojë fjalitë njëkryegjymtyrëshe; - të përcaktojë llojin e fjalive njëkryegjymtyrëshe (foljore dhe emërore); - të dallojë gjymtyrët homogjene; - të tregojë funksionin e gjymtyrëve homogjene në fjali; - të dallojë lidhjet sintaksore në fjali; - të përcaktojë llojin e lidhjeve sintaksore në një fjali; - të përcaktojë llojin e marrëdhënies në lidhjet sintaksore; - të dallojë fjalitë e përbëra të përziëra; - të dallojë ligjëratën e drejtë nga e zhdrejtja; - të përdorë ligjëratën e drejtë aty ku duhet. 	<p>Fjalìa. Llojet e fjalive sipas gjymtyrës kryesore. Fjalìa njëkryegjymtyrëshe. Gjymtyrët homogjene Llojet e lidhjeve sintaksore Marrëdhënie shtuese, kundërshtuese, veçuese, përmbyllëse Marrëdhënie kallëzuesore, përcaktore, kundrinore, rrethanore Fjalitë e përbëra të përziëra. Ligjëratat e drejtë dhe e zhdrejtë</p>



<p>Morfologji 14 orë</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë përemrat vetorë në rasa të ndryshme; - të përdorë drejt trajtat e shkurtra; - të dallojë foljet me funksion gjysmëndihmës; - të përdorë foljet me funksion ndihmës; - të përdorë foljet gjysmëndihmëse; - të përdorë foljet në formën veprorë dhe joveprorë; - të përcaktojë të ardhmen e së shkuarës tek foljet e mënyrës dëftore; - të dallojë foljet e mënyrës kushtore nga e ardhmja e së shkuarës së dëftores; - të tregojë rasën e parafjalëve; - të dallojë parafjalët nga emrat dhe ndajfoljet me të njëjtën formë; - të përdorë saktë parafjalën në rastet e përsëritjeve; - të përcaktojë llojin e pjesëzave sipas kuptimit; - të përcaktojë llojin e pasthirmave sipas kuptimit - të gjejë lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore; - të përdorë saktë lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore; - të dallojë lidhëzat nga përemrat ndajfoljet dhe parafjalët me formë të njëjtë. 	<p>Përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra.</p> <p>Foljet me funksion ndihmës dhe gjysmëndihmës.</p> <p>Format veprorë dhe joveprorë të foljes.</p> <p>E ardhmja e së shkuarës e dëftores dhe kushtorja.</p> <p>Parafjalët. Grupimi sipas rasave. Krahasimi i parafjalëve me ndajfoljet dhe emrat.</p> <p>Pjesëzat. Llojet sipas kuptimit.</p> <p>Pasthirrmat. Llojet.</p> <p>Lidhëzat. Krahasimi i lidhëzave me përemrat, ndajfoljet, parafjalët</p>
<p>Kulturë e gjuhës 3 orë</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojë regjistrat e gjuhës në tekste të ndryshme; - të përdorë regjistrat e gjuhës për qëllime të ndryshme në situata të ndryshme; - të përcaktojë stilet e gjuhës së përdorur në tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare; - të marrë njohuri për historinë e shkrimit shqip. 	<p>Regjistrat. Stilet e gjuhës. Historia e shkrimit shqip. (Dokumentet e para të shqipes së shkruar)</p>
<p>Drejshqiptim, drejtshkrim, pikësim 10 orë</p>	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shqiptohen si shkruhen me d, t dhe jo me dh, th fjalët e tipit: olimpiadë, temë, antologji etj.; - të shqiptohen me l, ashtu siç shkruhen dhe jo me ll fjalët me prejardhje të huaj si: <i>atlas, diplomat, diplomë, logjikë, psikologji etj.</i>; - të shkruajë me -ë fundore mbiemrat e formuar me anën e prapashtesës- të nga emra njërrrokësh, <i>i/e artë - art</i> ose me theks në rrokjen fundore <i>i/e pambuktë- pambuk</i> dhe me folje që mbarojnë 	<p>Tekste (fragmente) nga shkenca të ndryshme me ushtrime ilustruese</p> <p>ë- ja fundore</p>



	<p>zanore <i>i/e thatë- thaj</i>;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shkruajë me –ë fundore trajta e shumësit të emrave të tipit : <i>kilogramë, sanduiçë, kondicionerë</i> etj.; - të shqiptohen me c dhe jo me ç fjalët me prejardhje të huaj që shkruhen me c të ndjekur me <i>i/e</i>: <i>cisternë, acid, incizoj, koncert, koncesion</i> etj.; - të shkruajë me nyjen të mbiemrin e dytë, kur dy a më shumë mbiemra përcaktojnë një emër femëror të rasës gjinore, dhanore a rrjedhore njëjës; - të përdorë nyjen së te mbiemrat e nyjshëm të shkallës pohore kur vijnë pas një emri femëror të shquar; - të përdorë nyjen e përparme të, te njëjësi i mbiemrave të shkallës krahasore dhe sipërore të formuar me pjesëzën më, kur vijnë pas një emri femëror. - të përdorë nyjen të para mbiemrave të nyjshëm pas një emri të pashquar në rrjedhore; - të shkruajë të plotë grupin ye, ua, ue që shqiptohen si një rrokje e vetme (diftongje) - të përdorë shumëpikëshin në rastet e shkurtimeve të fjalëve a datave; në një ligjërim pa vijim logjik; para një fjale me ngarkesë emoconale; pas një numërimi që nuk jepet deri në fund; - të përdorë pikëpyetjen pas pjesëzash pyetëse ose pjesëzash të tjera që përdoren si fjali pyetëse; - të përdorë pikëpyetjen në rastet kur vijnë njëra pas tjetrës disa fjali të mëvetësishme; - të përdorë pikëçuditjen në fund të një periudhe me nënrenditje që ka si pjesë kryesore një fjali me karakter thirrmos; - të përdorë pikëçuditjen në fund të një periudhe që mbaron me një fjali me karakter thirrmos; - të përdorë pikëçuditjen pas një pasthirme të përdorur më vete, kur duam ta theksojmë; - të përdorë thonjëzat në struktura të veçanta (ironike) brenda një fjalie a teksti; - të përdorë thonjëzat tek ligjërata e drejtë. 	<p>Fjalë me prejardhje të huaj</p> <p>Drejshkrimi i nyjes së përparme</p> <p>Grupet e zanoreve ye, ua, ue Shumëpikëshi</p> <p>Pikëpyetja.</p> <p>Pikëçuditja</p> <p>Thonjëzat.</p>
--	---	---



V. TABELA PËRMBLEDHËSE E SHPËRNDARJES SË ORËVE

Nr	Linjat	%	Nr i orëve	Nënlinjat	
I	Të dëgjuarit & të folurit	8.5 %	13	1	Për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime
<p>Në praktikën e përditshme mësimore të gjitha orët e lëndës së gjuhës shqipe kanë të integruar punën e planifikuar me të folurit dhe të dëgjuarit. Edhe pse janë shënuar 13 orë në linjën I, faktikisht në strukturën e zbatuar programore kjo linjë do të zërë një % shumë më të madhe të kohës mësimore për vetë karakterin specifik të lëndës . Ajo del në pah pothuajse në të gjitha orët si element i qenësishëm i komunikimit.</p>				2	Të dëgjuarit dhe të folurit në grupe të vogla dhe të gjera.
				3	Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme.
				4	Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare.
				5	Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde.
				II	Të lexuarit
<p>Për linjën e të lexuarit janë planifikuar 65 orë, duke respektuar ndarjen e orëve të të lexuarit në strukturë, ku zë 37% të kohës mësimore. Kjo % në të vërtetë rritet gjatë praktikës mësimore, sepse zhvillimi i linjave të tjera nuk mund të realizohet po të mos integrohen brenda tyre lloje të ndryshme të të lexuarit.</p>				2	Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate.
				3	Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare
				4	Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje.
				5	Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe.
III	Të shkruarit	12,5 %	22	<p>1 Të shkruarit funksional për nevoja vetjake</p>	
<p>Për rëndësinë që ka kjo linjë në praktikën</p>					

mësimore dhe më gjerë, në jetën e përditshme të secilit nxënës paraqitet me 22 orë, të cilat edhe pse faktikisht në strukturën lëndore vjetore kanë tendencën për t'u rritur gati në 40% të sasisë së kohës mësimore aktive në klasë, përsëri janë të nevojshme. Në këtë nivel shkollimi kjo linjë do të ketë përparësi duke synuar madje të shkojë drejt një kulture të vetëdijshme të të shkruarit.				2	Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë.
				3	Të shkruarit duke praktikuar njohuritë rreth gjuhës.
IV	Njohuri rreth sistemit gjuhësor	30%	50	1	Sintaksë 18 orë
Edhe për linjën e katërt do të funksionojë e njëjta logjikë, sepse është e vërtetë që njohuritë rreth sistemit gjuhësor zënë 30% të orëve të programit mësimor, por është gjithashtu e vërtetë, që në linjat e tjera: të folurit, të lexuarit, të shkruarit nuk mund të mos integrohen njohuritë gjuhësore. Ato janë konceptuar jo vetëm si linjë më vetë, por edhe të përfshira brenda linjave të tjera.				2	Morfologji 14 orë
				3	Leksikologji. 5 orë
				4	Kulturë gjuhe 3 orë
				5	Drejshqiptim, drejtshkrim, pikësim 10 orë
V	Orë të lira	15%	25 orë	Orët do të planifikohen nga mësuesi sipas udhëzimeve të marra.	

VI. ZBATIMI I KURRIKULËS SË LIRË

Orët e lira kanë për qëllim t'i lënë hapësirat e nevojshme shkollës dhe mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit. Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël.

- Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor.
- Është fleksibël, sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Materiali mësimor që do të përgatitet dhe do të përzgjidhet nga mësuesi duhet t'i shërbejë realizimit të objektivave të programit dhe synimeve të përgjithshme të lëndës së gjuhës shqipe si lëndë formuese dhe si ndërlëndë që ndikon drejtpërdrejt në mbarëvajtjen e lëndëve të tjera.

Grumbullimi, sjellja në klasë dhe përdorimi i materialeve nga fusha të ndryshme të veprimtarisë intelektuale dhe praktike të njerëzimit, materiale letrare dhe jolettrare, grafikë, diagrame, materiale nga media e shkruar dhe elektronike, interneti, arkeologjia, astronomia, ekologjia, shëndeti i fëmijës, lojëra të popujve të ndryshëm, edukimi qytetar, fjalorth të specializuar për fusha që paraqesin interes për moshën etj., mund të kthehen në burime të vlefshme për të organizuar orë mësimore "pa mure" që janë interesante dhe bëhen promotorë edhe të zgjedhjeve afatgjata të nxënësve në jetë.

Organizimi i veprimtarive në natyrë, jashtë mureve të shkollës duke shfrytëzuar kushte të mjedisit në të cilin është shkolla, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në biblioteka, teatro, muze, shtëpi muze shkrimtarësh, vende me bukuri natyrore të spikatur, vende dhe qendra të rëndësishme për kulturën shqiptare, për historinë e kombit që kanë ndikuar fuqishëm në identitetin kulturor kombëtar, të shoqëruara me vrojtme dhe me detyra do të jetë një paketë praktikash në shërbim të realizimit të objektivave të caktuara të programit. Kjo paketë ndihmon për veprimtari të tjera. Kështu mund të bëhet:

- organizimi i konkurseve të fjalës artistike;
- organizimi i konkurseve "Lexuesi më i mirë";
- organizimi i lojërave të ndryshme zbavitëse që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive intelektuale dhe pjesëmarrëse që fuqizojnë të nxënësit edhe zhdërvjelltësojnë procesin e mësimdhënies, që zhvillojnë të menduarit logjik dhe kritik;
- përforcimi i njohurive përmes improvizimeve të dramatizuara apo lojës me role;
- shkëmbim letrash me qëllim përforcimin e njohurive të marra në zhvillimin e të shkruarit, të shoqëruara me metoda dhe strategji që fuqizojnë si mësimdhënien ashtu edhe të nxënësit duke luajtur;
- organizimi i konkursit "Shkrimi më i bukur";
- intervista me prindërit për përvoja të përbashkëta edhe pse në kohë të ndryshme;
- mbledhja e materialeve folklorike nga krahina e origjinës së tyre;
- kërkime folklorike, arkeologjike dhe raportimi me shkrim i punës së kryer.

Këto janë disa veprimtari rekomanduese që mund të zhvillohen nga mësuesi.

Bashkëpunimi me mësuesit e lëndëve të tjera është një mënyrë tjetër e realizimit të orëve të lira. Për këtë, duhet hartuar paraprakisht një plan i përbashkët disaorësh, në formën e një projekti. Kjo veprimtari e përbashkët mundëson lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspekte

kroskurrikulare. Nxënësve u jepen detyra që përfshijnë njohuri ndërlëndore të cilat i shërbejnë arritjes së objektivave të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive është element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës së orëve të lira. Kjo do të mundësohet duke analizuar me kujdes si programin ashtu edhe kërkesat që parashirojnë veçoritë vendore ku gjendet shkolla.

Realizimi i sugjerimeve të mësipërme kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por edhe aftësinë e një hartuesi të vërtetë kurrikule, për rrjedhojë, edhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart në vetvete ky rol.

Kujdes duhet bërë që:

- a) orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë, të cilat jo vetëm që nuk shënojnë risi, por ia humbin karakterin inovativ kësaj rubrike në kurrikulën shkollore;
- b) të mos planifikohen të gjitha orët në një periudhë kohore, por të shtrihen gjatë vitit.

VII. INTEGRIMI

Lënda e gjuhës shqipe për klasën e 9^{te} është bazuar në integrimin e lëndëve në vazhdim të integritit mes dy disiplinave: gjuhë shqipe dhe lexim.

Mënyrat e integritit

- Integrimi ndërlëndor (gjuhe shqipe, tekste letrare dhe joletrare të llojeve dhe gjinive të ndryshme)
- Integrimi ndërmjet fushave të studimit
- Integrimi në planin e bashkëveprimit të objektivave për çdo fushë
- Integrimi në përdorimin e metodave ndërvepruese në mësimdhënie

Integrimi ndërlëndor nënkupton që zbatuesit e këtij programi duhet :

- të realizojnë natyrshëm integrimin e njohurive bazë nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes me fusha të tjera të dijës, si: arti i fjalës, historia, gjeografia, matematika, teknologjia, edukata qytetare, ruajtja e mjedisit, etj.;
- të zbatohet integrimi në program përmes respektimit të larmisë tematike.

Integrim në metodë

Mësues/i,-ja duhet të vendosë nxënës/in,-en në qendër të procesit mësimor. Për këtë duhet të shfrytëzojë studime të didaktëve të shquar të traditës ose bashkëkohorë, shqiptarë e të huaj, si edhe përvojat jetësore të tij/saj.

Për të rritur gjithëpërfshirjen e nxënësve, duhet të përdoren edhe materiale të komunikimit masiv bashkëkohor, të siguruara nga burime alternative.

Është e rëndësishme të theksojmë se brenda një ore mësimi duhet të realizohen: të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit, pavarësisht se cila linjë do të ketë peshë specifike më të madhe.

17


VIII . VLERËSIMI

Një nga proceset bazë që qëndron në themel të të mësuarit të lëndës është vlerësimi. Ky proces shënon përgjegjësi të rëndësishme dhe sigurisht kërkon përmirësim të vazhdueshëm në kontakt me parametrat bashkëkohorë.

Synimet e vlerësimit janë:

- sigurimi i informacionit të nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm mbi nivelin e njohurive, motivimin e tyre drejt të mësuarit duke përcaktuar mundësitë e tyre reale për nxënie;
- shkalla e realizimit të objektivave të përcaktuara në programin mësimor;
- nxitjen e interesit të nxënës/it,-es për ngritjen e nivelit të arritjeve të tyre.

Komponentët e vlerësimit janë:

Vlerësim i vazhdueshëm me gojë dhe me shkrim.

Për vetë natyrën e lëndës dhe rëndësinë e madhe të vlerësimit të aftësive komunikuese, vlerësimi i vazhdueshëm me gojë dhe me shkrim është i domosdoshëm dhe udhëheq punën e përditshme mësimore në lëndën e shqipes. Në dobi të nivelit të punës vlerësuese është pa dyshim vendosja e kritereve vlerësuese, njohja e standardeve, që duhen konsideruar piketa të përcaktuara profesionalisht, si rezultate të pritshme që duam të arrijmë. Në këtë linjë është vlerësimi i nxënësit dhe niveli i punës së bërë prej tij sipas standardeve të arritjes.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kritereve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve, ndaj ato duhet të jenë motivuese.

Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

IX. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përvetësimi i programit të gjuhës shqipe klasa e 9^{te} bëhet cilësor, kur mësuesi mundëson që:

- nxënësit në orën e gjuhës shqipe të sjellin në klasë përvoja personale, interesa, qëndrime të caktuara ndaj dukurive gjuhësore;
- nxënësit të provojnë një seri rolesh në procesin e të nxënit (*atë të ftuesit në bashkëpunim, dëgjuesit të vëmendshëm, inkurajuesit, udhëheqësit, mbështetësit, nxitësit, motivuesit, lehtësuesit, vlerësuesit etj.*);
- çdo temë të shoqërohet me rubrika të pasura, paraqitje skemash dhe grafikësh të thjeshtë, si ato që nxënës/i,-ja has në jetën e përditshme; ndërthurja e tyre synon ta mundësojë natyrshëm integrimin;
- rimarrja si një parim didaktik të bëhet pjesë e mësimit të gjuhës shqipe, me qëllim lidhjen dhe përforcimin e shprehive letrare dhe gjuhësore;
- të nxënësit të realizohet përmes nxitjes së nxënësve për të qenë aktivë për të marrë përgjegjësi të ndryshme;

- nxënësve t'u jepen shanse të dinë më shumë për dukuritë dhe ligjësitë gjuhësore dhe letrare.

Rëndësi të veçantë ka praktikimi i asaj që nxënësit dinë të bëjnë, larg mbingarkesave teorike, pra të kalohet nga mësimdhënia me drejtim riprodhues, në një mësimdhënie ku nxënësi kërkon, gjen, zbulon, zgjidh, analizon, provon, madje edhe sintetizon.

Planifikimi i veprimtarive mësimore, të tilla si: të folurit në grupe të vogla e të mëdha, të lexuarit shprehës dhe recitimi, të shkruarit për qëllime dhe audienca të ndryshme duhet të jenë pjesë përbërëse e çdo ore mësimi.

Punët me shkrim të tipit: ese, shkrim i lirë, përshkrim, portret apo modele të tjera të shkruari, edhe pse të thjeshta, të jenë të paraprirë nga njohje, analiza, imitime të krijimeve të të njëjtës natyrë të marrë nga trashëgimia jonë letrare dhe nga krijimtaria botërore.

Kërkesa për punë me shkrim, të mos varet apo plotësohet vetëm nga orët e veçanta të planifikuara për to në program, por medoemos të bëhet pjesë përbërëse e shtjellimit të plotë të temës përkatëse duke shtuar edhe kërkesa që lidhen me modelimin e shkrimit.

Procesi mësimor të pasurohet dhe të shoqërohet me tabela, diagrama, grafike, foto dhe skica të tjera, që shoqërojnë natyrshëm materialin verbal të shkruar.

Kujdes në drejtim të shmangies së mbingarkesës mësimore; duhet përdorur terminologji e thjeshtuar, në përshtatje me moshën dhe të ruhet sensi i masës në dhënien e koncepteve apo detyrave mësimore.

Pjesët përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe e huaj të jenë në përshtatje me moshën dhe interesat e nxënësve, duke plotësuar kriteret didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës.